



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të

Nr. 48/09

Prishtinë, më 22.04.2009, ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: **Gani Koci, Haki Shatri, Kosara Nikolić, Myrvete Pantina, Xhevdet Neziraj, Riza Smaka, Müfera Şinik, Besa Gaxherri, Hajdin Abazi, Shkumbin Demaliaj, Naser Osmani, Safete Hadërgjonaj.**

Nga stafi mbështetës i Komisionit: **Natasha Prica-Tisma, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli, Fatmire Vojvoda (praktikante), Gazmend Avdyli (praktikant).**

Gjithashtu të pranishëm ishin: **Bedri Hamza zv.ministër i MEF-it, Zv. Drejtori i Thesarit, Përfaqësuesit nga KPMM dhe ZRRE, ART, Teki Shala nga NDI, monitorues Zyra e Presidentit, OSCE, ICO, KDI.**

Kryesues: Gani Koci, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 1.04.2009;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar mbi Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2008**
I ftuar: Ministri i Ministrisë për Ekonomi dhe Financa;
- 4. Shqyrtimi i pjesës financiare të Raportit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, Zyrës së Rregullatorit për Energji, Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit, për vitin 2008;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit për produktet Biocide nr.03/L -119 me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente;**
- 6. Të ndryshme.**

Kryesuesi, hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendit ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 1.04.2009

Kryesuesi, konstatoi se procesverbali nga mbledhja e kaluar dt. 1.04.2009, miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar mbi Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2008

I ftuar: Ministri i Ministrisë për Ekonomi dhe Financa

Kryesuesi, theksoi se raporti i përmbush kushtet ligjore për raportim. Për të dhënë informacione shtesë rreth këtij raporti, ia dha fjalën zv.ministrit të MEF-it, z. Bedri Hamza.

Bedri Hamza zv.ministër i MEF-it, theksoi se në bazë të ligjit, MEF-i ka hartuar raportin vjetor për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2008, i cili është në përputhje me standartet e kontabilitetit, dhe të njëjtin e ka proceduar brenda afatit ligjor për në Kuvend. Nga të dhënat e prezantuara në raport, shifet se të hyrat e rregullta për vitin 2008 kanë pasur performancë të mirë, 14 % më tepër se në periudhën paraprake, ndërsa 6 % mbi planin. Të hyrat kryesore janë realizuar nga doganat që janë 1(3 % më tepër se në periudhën paraprake, ndërsa 4 % mbi planin). Pastaj të hyrat nga ATK-ja (16% më shumë se 2007 dhe 9 % mbi planin). Rritje kanë shënuar edhe të hyrat në nivelin qendrorë (11% më tepër se 2007 dhe 29 % mbi planin), të hyrat vetanake në nivelin qendror, të hyra nga komunat (12% më tepër se 2007). Ndërsa sa i përket shpenzimeve ngritje të madhe kanë shënuar shpenzimet kapitale (124% më tepër se në vitin 2007). Shpenzimet për paga dhe mëditje 9% më tepër se 2007 (si rezultat i krijimit të institucioneve të reja, rritja e pagave për personelin arsimor). Rritje kanë shënuar edhe shpenzimet për mallra dhe shërbime (10%), shpenzimet komunale (3%) si dhe shpenzimet për subvencione dhe transfere (37%).

Haki Shatri, theksoi se raporti i plotëson kushtet ligjore të raportimit. Shifet se përkundër vështërsive në disa pika doganore, trendi i të hyrave ka shënuar rritje. Ndërsa te shpenzimet shifet se nuk ka tejkalime të buxhetit, përveç në kategorinë paga dhe mëditje. Vlerësoi rritjen e shpenzimeve kapitale. Megjithatë theksoi do të ishte mirë që raportit ti bashkëngjitet edhe shtojca e realizimit të projekteve kapitale, e cila ndihmon në vlerësimin e arsyeshmërisë dhe cilësisë së realizimit të tyre. Andaj kërkoi që para shqyrtimit në Kuvend ti bashkëngjitet edhe kjo pjesë. Z. Shatri theksoi se e brengos fakti i rritjes së kostos së projekteve kapitale të planifikuara në krahasim me vitet e kaluara. Lidhur me këtë pyeti cilët janë faktorët që kanë ndikuar në rritjen e kësaj kostoje.

Besa Gaxherri, theksoi se raporti është i papranueshëm. Nga të dhënat e prezantuara shifet se shumat totale e të hyrave për vitin 2008 është 1,033,145,000 € krahasuar me vitin 2007 që është 1,170,3660€ Pyeti se në shumën totale të buxhetit të vitit 2008, a është bartur edhe suficiti i vitit 2007 apo këto tregojnë të hyrat e rregullta. Sa i përket shpenzimeve kapitale shifet se mbi 80% e tyre janë shpenzuar në tre mujorin e fundit të vitit (rasti i Ministrisë së Transportit e cila gjatë nëntëmujorit ka shpenzuar 25% të investimeve kapitale, ndërsa në tre muajt e fundit kjo shifër ka arritur në 90%). Edhe të dalurat kanë shënuar rritje të mëdha. Rasti i ngritjeve në kategorinë mallra dhe shërbime, shpenzimet për qira. Vlerësoi të domosdoshëm bashkëngjitet e pjesës së projekteve kapitale të realizuara, para shqyrtimit të raportit në Kuvend. Në fund pyeti se a është suficiti i vitit kaluar 2,227,000€

Naser Osmani, përkrahu raportin.

Xhevdet Neziraj, duke komentuar raportin theksoi se ka rritje të të hyrave por edhe të shpenzimeve. Të tilla janë shpenzimet për qira, mobileve, derivate të naftës, shpenzimet e përfaqësimit. Vërejte bëri për realizimin e pjesës më të madhe të shpenzimet kapitale janë bërë në tre muajt e fundit. Mbështeti kërkesën për bashkëngjitjen e projekteve kapitale. Sipas z. Neziraj problemi më shqetësues paraqet suficitin i lartë, përkundër gjendjes së vështirë ekonomike në vend. Në këtë drejtim do të duhej që planifikimi i buxhetit nga organizatat buxhetore të bëhet konform kapaciteteve për realizimin e tij. Gjithashtu theksoi se do të duhej të saktësohej termi “pagat për komunitet”, sepse nga ai nuk kanë përfituar të gjithë komunitetet.

Safete Hadërgjonaj, vlerësoi punën të mirë përmisimin e teknikës së raporteve, që po ndodh çdo vit. Vlerësoi të suksesshme rritjen e të hyrave në të gjitha kategoritë, që janë më të larta se vitin 2007, si dhe tejkalojnë planin. Edhe shpenzimet janë rritur, në veçanti gëzon fakti i rritjes të dukshme të investimeve kapitale. Ndërsa nëse analizojmë më vëmendje raportin shohim se në të gjitha institucionet kemi rënje të shpenzimeve në mallra dhe shërbime. Mbështeti gatishmërinë e zv.Ministrit që raportit të bashkëngjitet edhe pjesa me projektet e realizuara kapitale. Përndryshe përkrahu raportin.

Riza Smaka, vlerësoi të përgatitur mirë raportin. Megjithatë konsideroi të dobishme bashkëngjitjen e projekteve kapitale që të mund të shihet cilësia e realizimit të tyre. Në këtë drejtim theksoi se do të ishte mirë të bëhej një rikapitulim për shifrat e prezantuara në raport që të mund të kuptohej nga të gjithë të interesuarit. Suficiti duhej të trajtohet shumë seriozisht.

Myrvete Pantina, vlerësoi raportin të përgatitur mirë teknikisht. Shifet se kemi rritje të të hyrave dhe shpenzimeve. Të hyrat më të mëdha janë realizuar nga komunat. Ndërsa të hyrat e realizuara nga ATK-ja edhe pse kanë shënuar rritje prej 10%, theksoi se ka hapësirë që të punohet më shumë që të realizohen të hyra më të mëdha (shmangja e evazionit fiskal). Nga përshkrimi gjohet dhe tarifat shifet se ka rënie në krahasim me periudhën paraprake, pyeti e është kjo për shkak të disiplinës. Po ashtu kërkoi sqarime pse nuk kemi të dhëna për të hyrat nga licencat për lojërat e fatit, nga qiraja për objekte publike dhe nga renat. Konsideroi të rëndësishme rritjen e shpenzimeve kapitale, ndërsa vërejtje bëri për avancet e pambyllura si dhe pagesat për qiratë në objektet private përkundër vendimit të qeverisë për vendosjen institucioneve në objekte publike.

Kryesuesi, duke u ndërlidhur në diskutime theksoi se raporti i plotëson të gjitha kushtet ligjore të raportit. Mungon vetëm pjesa e projekteve kapitale që nuk është obligim ligjor, por për me qëllim të pasqyrimit komplet të raportit mund të kërkojmë që ajo t'i bashkëngjitet para shqyrtimit të Kuvendit. Më pas kërkoi sqarim për përshkrimin “Letra me vlerë për Qeverinë” në shumën prej 266,477,000 € kur dihet se ende nuk kemi Ligj për investimet në letrat me vlerë.

Bedri Hamza zv.ministër i MEF-it, në përgjigjen e pyetjes për të hyrat e rregullta buxhetore theksoi se ato janë 942,52,000€ ndërsa pjesa tjetër janë të hyra nga burimet tjera. Në pyetjen për suficitin, theksoi se nëse i krahasohen të hyrat dhe shpenzimet me vitin 2007 nuk kemi suficit, porse shumat e mbetura figurojnë në raport si të tilla, për të përmbushur obligimet që ka Kosova, të cilat nuk po realizohen në mungesë të marrëveshjeve politike (psh. borxhi i jashtëm). Në pyetjen për shpenzimin e pjesës më të madhe të buxhetit në tre muajt e fundit, theksoi se Ligji i buxhetit parasheh periudhën një vjeçare të realizimit të tij. Pagat për minoritetet kështu janë quajtur, ndërsa dihet destiniminin e tyre. Qiraja për institucionet e vendosura në objekte private ka vazhduar për shkak se është vështirë që brenda një viti të bëhet akomodimi i tyre në objekte publike. Në pyetjen e kryetarit, theksoi se kemi të bëjmë me letrat me vlerë të investuara nga BQK-ja në emër të Qeverisë që kanë sjellur përfitime në vlerë prej 10 milion €. Në lidhje me kërkesën për bashkëngjitjen e pjesës në pasqyrimin e projekteve kapitale edhe pse ligji nuk obligon, me qëllim të sqarimeve të raportit, u pajtua se do t'ia bashkëngjitet raportit para shqyrtimit të tij në Kuvend.

Pas vërejtjeve, propozimeve dhe sugjerimeve, Kryesuesi konstatoi se me 10 vota Për, një Kundër (z. Xhevdet Neziraj) dhe asnjë Abstenim, Komisioni nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni e shqyrtoi Raportin financiar të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2008 dhe konstatoi se i njëjti i plotëson standartet e raportimit financiar, si dhe standartet ndërkombëtare të kontabilitetit, dhe është në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.
- II. Në bazë të analizës së bërë, Komisioni vlerësoi të nevojshme dërgimin e pasqyrave detale të investimeve kapitale me paranë publike, të cilat janë bërë gjatë vitit fiskal, para shqyrtimit të tij në Kuvend, me qëllim të plotësimit të plotë të Raportit financiar të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitin 2008.

4.1. Shqyrtimi i pjesës financiare të Raportit të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2008

Kryesuesi, për të dhënë informacione shtesë rreth raportit, ia dha fjalën përfaqësuesit të ZRRE-së.

Ali Hamiti, shpjegoi të hyrat dhe shpenzimet ashtu siç ishin të prezantuara në raport. Nga jo shifet se kemi shpenzime më të ulëta në krahasim me ato të planifikuara. Arsyeja mos realizimit të tyre ka ndodhur për shkak të moskompletimit të stafit, realizimi i projekteve nga donacionet. Z. Hamiti përmendi problemet që po has kjo zyrë në realizimin e mjeteve suficitare për paga dhe kompenzime tjera të të punësuarve të kësaj zyre në vitin vijues, për shkak të pengesave ligjore.

Haki Shatri, përkrahu raportin dhe njëkohësisht theksoi se do të duhej të barteshin mjetet kësaj zyre nga thesari për këtë vit konform ligjit. Ndërsa për shkallën e ultë të shpenzimeve theksoi se më mirë është që paratë të mos shpenzohen, se sa të bëhen pa kritere.

Safete Hadërgjonaj, vlerësoi pjesën financiare të raportit si të mangët. Në kategorinë paga dhe mëditje shifet se për dy punëtor të mosrekrutuar kanë mbetur pashpenzuar 26.000€ çka tregon një planifikim jo të mirë të buxhetit nga kjo zyrë. Theksoi si komision të kërkohet që të plotësohet raporti me të dhëna të detalizuara konform formularëve standard, në të cilët paraqiten buxheti i planifikuar për 2008, buxheti i shpenzuar gjatë këtij viti, krahasimi i tyre në përqindje si dhe krahasimi me vitin 2007.

Kryesuesi, duke u ndërlidhur me pengesat ligjore që ballafaqohet kjo zyrë në financimin e tyre për paga dhe mëditje, theksoi se një rekomandim i komisionit do të duhej të ishte që Qeveria dhe Kuvendi të fillojnë procedurat e ndryshimit të nenit që paraqet këtë problem në funksionimin e kësaj zyre. Ndërsa përkrahu kërkesën që ky raport të plotësohet në pjesën financiare konform formularëve standard para shqyrtimit të tij në Kuvend.

Riza Smaka, gjithashtu përkrahu mendimin që të shmangen dispozitat që janë në kolizion me njëra tjetrën, e që paraqesin probleme në funksionimin e kësaj zyre. Në vazhdim kërkoi sqarim se qfarë është dallimi në mes licencës dhe lejes speciale.

Besa Gaxherri, duke parë vakumin ligjor që ekziston, propozoi që të ndërhyhet në ligj për të zgjidhur problemet e financimit që ballafaqohet kjo zyrë, ose në kërkesën buxhetore për vitin vijues

të kërkohet buxhet saktësisht sa ka nevojë kjo zyrë. Përgëzoj përfaqësuesit e kësaj zyre për kursimet e buxhetit, si rezultat i marrjes së donacioneve në investimet kapitale.

Hajdin Abazi, u pajtua me mendimet që të përgatitet pjesa e buxhetit konform formularëve standard të raportimit. Pyeti sa anëtar ka ZRRE-ja.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni ka shqyrtuar Raportin e Zyrës së Regullatorit për Energji për vitin 2008, dhe ka kërkuar plotësimin e tij me detaje të Pasqyrave financiare (forma standarde të përcaktuara nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave), para shqyrtimit të tij në Kuvend.
- II. Komisioni propozon që Kuvendi dhe Qeveria e Republikës së Kosovës të shqyrtojnë mundësinë e ndryshimit të nenit 20.3 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, me qëllim të zgjidhjes së vështirësive në financimin e këtij Rregullatori.

4.2. Shqyrtimi i pjesës financiare të Raportit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2008

Kryesuesi, për të dhënë informacione shtesë rreth raportit ia dha fjalën përfaqësuesit të KPMM-së.

Ibush Jonuzi, shpjegoi pasqyrat e prezantuara në raport. Theksoi se buxheti i KPMM-së është realizuar 94%. Përmendi projektin kapital të papërfunduar si rezultat i mosërbushjes së kontratës nga kontraktuesi.

Safete Hadërgjonaj, vlerësoi raportin e përgatitur mirë teknikisht. Megjithatë bëri vërejtje për disa shpenzime të tejkaluara, si shpenzimet e telefonit, karburantet për veturat, sigurimi i ndërtesës, servisimin e automjeteve, qiraja. Gjithashtu bëri vërejtje edhe për mosmbylljen e avanceve. Shqetësues paraqet fakti se një pjesë e të hyrave nga operatorët nuk është inkasuar. Do të kishte qenë mirë të shihnim se qfarë keni ndërmarrë në këtë drejtim si agjencion. Një raport i auditimit të jashtëm do të ndihmonte për të parë specifikat e buxhetit.

Shkumbin Demaliaj, vlerësoi raportin mirë të përgatitur. Theksoi se ky komisioni ka kryer mirë punën e tij, të hyrat që kanë realizuar kanë rritur buxhetin e Kosovës. Ndërsa shpenzimet e bëra për telefon dhe karburant kanë rrjedhur për shkak të punëve në teren që bëjnë. Për t'iu shmangur shpenzimeve për qira, është dashur që qeveria të zgjidh problemin e vendosjes në objektet publike. Duke komentuar vërejtjet për mosikansimin e faturave për miniera, theksoi se kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së një strategjie të Qeverisë për shfrytëzimin e minierave dhe mineraleve. Në vazhdim pyeti se komisioni a kanë dhënë licencë ndonjë operatori për minierat e kromit.

Myrvete Pantina, theksoi se është e kënaqur me raportin. Nëse krahasohen të hyrat e inkasuara dhe buxhetin që kanë pasur në dispozicion, shifet se është shënuar një progres në inkasimin e të hyrave. Megjithatë shqetësues paraqet fakti i operimeve ilegale në këtë fushë, gjë që po ndikon edhe në të hyrat buxhetore. Pyeti se qfarë rekomandimesh keni bërë për të ndërmarrë veprime ndaj këtyre operatorëve ilegal.

Besa Gaxherri, vlerësoi raportin mirë të përgatitur teknikisht dhe të qartë. Megjithatë është dashur të jepen sqarime për shpenzimet e tejkaluara të telefonit, karburanteve, për mosmbylljen e avanceve. Ndërsa për shmangien e pengesave që has kjo zyrë, duhet të kujdeset Kuvendi.

Haki Shatri, theksoi se puna që është bërë nga ky komision arsyeton shpenzimet e bëra. Shifet së gjatë viteve 2006-2008 është bërë ngritja e të hyrave 100 % dhe në anën tjetër zvogëlimi i shpenzimeve në 50 %. Natyra e punëve ka ndikuar në tejkalimin e buxhetit në disa kategori. Përndryshe përkrahu raportin.

Hajdin Abazi, duke u ndërlidhur me shpenzimet e telefonisë mobile, pas një përlllogaritje shifet se janë shpenzuar 300€ për person. E që po të bëhej abonimi mujor shpenzimet do të uleshin për 40%.

Kryesuesi, duke u ndërlidhur në diskutimet, theksoi se shifen disa shuma të larta të shpenzimeve në mirëmbajtjen e automjeteve si dhe në mirëmbajtjen e objektit. Lidhur me këto kërkoi sqarime.

Ibush Jonuzi, duke i përgjigjur pyetjeve dhe vërejtjeve për shpenzimet e telefonisë theksoi arseja e tejkalimit të tyre ka ndodhur për shkak të punës në teren, gjithashtu edhe për karburantet. Kostoja e lartë për servisimin e veturave ka ndodhur për shkak të vjetërsisë së tyre. Për shpenzimet për qiranë kemi bërë kërkesën ndër të parët për vendosjen në objekte publike, ndërsa lidhur me shpenzimet për sigurimin e objektit, atë e bënë kompania që ka ofrua çmimin më të ultë në tender. Numri total i punëtorëve është 64. Sa i përket pyetjes për problemin e moskantsimit të plotë të taksave dhe veprimeve ilegale, një pengesë të këtillë e paraqet edhe vetë ligji. Ndërsa në pyetjen për licencat për minierat e kromit, theksoi në zonat që konsiderohen të interesit kombëtar nuk është dhënë ndonjë licencë.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni ka shqyrtuar pjesën financiare të raportit të KPMM-së për vitin 2008, dhe ka konstatuar se i njëjti i plotëson të gjitha standardet e raportimit financiar, prandaj i rekomandon Kryesisë së Kuvendit që raportin ta radhisë në rend të ditës për debat në seancën plenare.

4.3. Shqyrtimi i pjesës financiare të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit për vitin 2008

Kryesuesi, për të dhënë informacione shtesë rreth raportit ia dha fjalën përfaqësuesit të ART-së.

Fatmir Miraka, shpjegoi të dhënat e prezantuara në raport. Theksoi se kanë pasur problem në realizimin e një projekti kapital, për shkak të pengesave të shfaqura me procedurat e prokurimit, të cilat më vonë janë tejkaluara. Problemet me zgjedhjen e bordin, po ndikojnë në punën e ART-së.

Riza Smaka, duke u ndërlidhur me veprimin e operatorëve ilegal, pyeti pse nuk keni marrë masa ndaj operatorëve të palicencuar.

Shkumbin Demaliaj, pyeti a është e vërtet që ka antenë të operatorëve ilegal mbi ndërtesën e Qeverisë.

Safete Hadërgjonaj, bëri vërejtje për mosdorëzimin e raportit për vitin 2007 në Kuvend, si dhe mosdorëzimin e kërkesës buxhetore për vitin 2009. Në këtë drejtim nuk jemi njoftuar për aktivitetet e ART-së gjatë kësaj periudhe. Duke qenë në njohuri për skadimin e mandatit të anëtarëve të bordit të ART-së, pyeti a ka ndonjë vendim për vazhdimin e mandatit të tyre. Përndryshe për shkak të paqartësive rreth mandatit të bordit, po amortizohet puna e ART-së për disa vite. Lidhur me raportin

e auditorit të pavarur, theksoi se i ka bërë përshtypje për të keq, i cili nuk përmban rekomandime dhe si i tillë ka qenë i panevojshme t'i bashkangjitet këtij raportit.

Besa Gaxherri, bëri vërejte për punën e ART-së, në të cilin problemet ekzistojnë prej themelimit. Është një agjencion që është jashtë funksionit, mbështetjes dhe kontrollit institucional. Mosveprimi pas skadimit të mandatit të bordit, tregon se edhe ne nuk jemi në nivelin e detyrës.

Fatmir Miraka, lidhur me pyetjen e z. Demaliaj, theksoi se ai nuk është përgjegjës për atë punë dhe nuk është në dijeni për këtë.

Kryesuesi, theksoi se bordi aktual ka njoftuar për skadimin e mandatit të tyre dhe përgjegjësia bie në institucionet përgjegjëse. Duke ditur problemet që ekzistojnë në këtë agjencion prej themelimit e deri më sot, dhe në mungesë të personave kompetent (anëtarëve të bordit), komisioni nuk mund të marrë qëndrim për raportin e vitit 2008. Komisioni kërkon nga Kuvendi të diskutoj për gjendjen e gjithëmbarshme të ART-së. Njëkohësisht kërkon që të përmbushet ana ligjore për përzgjedhjen e anëtarëve të bordit të ART-së.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni diskutoi pjesën financiare të Raportit të Autoritetit Rregullator për Telekomunikacionin për vitin 2008, dhe në mungesë të personave kompetent për raportim, nuk mori ndonjë përfundim të caktuar.
- II. Komisioni i rekomandon Kuvendit dhe Qeverisë që të fillojnë procedurën për emërimin e përbërjes së re të Bordit të ART-së për shkak të skadimit të mandatit të tyre.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për produktet Biocide nr.03/L -119 me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi , Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen për Projektligjin dhe amendamentin e komisionit funksional lidhur me mundësinë e implikimeve financiare.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për produktet Biocide dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

Mbledhja përfundoi në ora 13:35

Përgatitur nga

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit,

